



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 33/15

Prishtinë, më 4.11.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Ilir Deda, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Ministër i Financave, Agim Krasniqi - zv.ministër i financave, Petrit Popova – Drejtori i Buxhetit Komunal në MF, Milaim Aliu, U.d. Drejtor i Buxhetit Qendror në MF.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Visar Pretreza- Gazetar i Kohës Ditore, Sanije Berisha – Monitoruese nga OSBE, Lumnije Murati - Udhëheqëse në Zyren e Presidentes, Fjolla Uka – monitoruese nga KDI, Shefki Krasniqi-nga NDI, Besa Maliqi- Gazetare nga BIRN, Elvim Sefiu – Gazetar nga Tribuna, Ekrem Pasjaqa-Gazetar nga Mediapres, Kushtrim Ahmeti- Gazetar nga KTV, Visar Krasniqi - Gazetar nga RTK, Drilon Asllani-Gazetar nga Radio Dukagjini, Albulena Mavraj-Gazetare nga Epoka e Re.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 21.10.2015;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-327;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmuorin e vitit 2015;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Amendamenteve të Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-18 për Provimin e Maturës Shtetërore dhe Amendamenteve të Komisioni funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – propozoj që rendi i ditës të ndryshohet. Të shtohet një pikë e re: Shqyrtimi në parim i Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe pika e 4 të shtyhet për një mbledhje tjetër, për shkak të mungesës së sekretarit, që gjindet jashtë vendi.

Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës, me ndryshime. Shtohet një pikë e re pikë e 3 me radhë: Shqyrtimi në parim i Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe pika e 4 të shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 21.10.2015

Kryetari - konstatoi e procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryetari – konsiderojmë se ky buxhet do të ruaj stabilitetin makrofinansiar dhe funksionalizimin e institucioneve të Kosovës dhe është në harmoni me zhvillimin ekonomik që te kemi një buxhet të realizueshëm. Konsiderojmë se reforma do të ketë një ndikim në buxhet 2016, ashtu siç do të kenë edhe ligjet e rregullës fiskale. Zbatimi i MSA-së, përveç impaktit në rënien e të hyrave doganore ajo mund të ketë edhe efekt pozitiv për shkak qarkullimit më të madhë të mallrave dhe rritjes së të hyrave nga TVSH. Buxheti i 2016 do të ruaj qëndrueshmërinë në investimet kapitale dhe me ndryshimet e rregullës fiskale që ka të bëjë krijimin e mundësisë për huazim të jashtme do të krijojë mundësinë për financimin e projekteve strategjike.

Avdullah Hoti - buxheti është hartuar mbi parimin i qëndrueshëm. Ky buxhet merret me balancimin e të hyrave dhe shpenzimeve, për të ruajtur bilancin bankar të pacenueshëm me praktikën më të mira dhe me kërkesat e FMN-së. Me këtë buxhet ne sigurojmë financim më të plotë për të gjitha projekt kapitalët që janë në vazhdimësi të implementimit dhe jemi siguruar me ministrit e linjës që të respektojmë plotësisht kontratat e nënshkruara që këto projekte të kryhen në mënyrë të papenguar. Në buxhet shihen edhe masat për plotësimin e kushteve për biznesin ose masa që kemi ndërmarrë për akomodimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, siç janë MSA ose marrëveshjet tjera dhe kemi siguruar një balanc për financimin e nevojave buxhetore për tu siguruar që rritja e borxhit në këtë moment nuk shkon në dëm të projekteve afatgjate. Për tri vitet e ardhshme është vlerësuar se do të ketë një rritje ekonomike prej rreth 4.2%, që është kryesisht nga investimet dhe rritjes së sektorit privat, të eksporteve për 7%, konsumit agregat 3.5% , duke mos i marr parasysh projektet e mëdha, siç është rasti i Projektit të Kosovës së Re, Projekti i Brezovicës, që do ti japin efektet në tri apo katër vitet e ardhshme.

Të hyrat e rregullta buxhetore që ne i kemi paraparë për vitin 2016 janë 1,598 milion euro, që janë për 4.1% më të mëdha krahasuar me buxhetin e këtij viti dhe 19% e viti 2014. Ne presim të kemi rritje të të hyra nga dogana dhe nga administrata tatimore për 6.2 dhe 8.8% respektivisht. Në planifikimin e të hyrave ne kemi marr parasysh efektet që do ti ketë pakoja e re fiskale dhe presim që kostoja e saj të jetë rreth 16 milion euro. Në projektsionin e të hyrave gjithashtu është kostoja buxhetore e MSA-së që presim të ketë efekt të drejtpërdrejtë buxhetor rreth 24 milion euro.

Sa i përket shpenzimeve 2016, do të jenë 1,680 milion euro. Kemi siguruar hapësirë në mënyrë të papenguar të financohen rritja e asistencës sociale për 25%, kemi mundësuar një rritje të buxhetit për skemat e pensionale të financuara prej shtetit, për pensionistët kontributdhënës dhe buxheti për këtë kategori është 68 milion euro, kemi krijuar hapësirë për të financuar plotësisht përvojën e punës për 80,000 shërbyes civil, që kushton rreth 30 milion euro. Kemi siguruar mbarëvajtjen e financimit të bujqësisë përmes subvencioneve e granteve dhe investime kapitale janë pak më shumë në këtë vit, por duke e ndryshuar strukturën e investimeve në bujqësi. I kemi akomoduar plotësisht shpenzimet që dalin

nga agjenda integruuese që ka Kosova, kemi siguruar buxhet shtesë për sundimin e rendit dhe ligjit, është rritur buxheti për prokurori për 13 % dhe për gjyqësi 5% dhe rritje e buxhetit për forcat e sigurisë së Kosovës. Shumica e kësaj hapësire që është në buxhet vjen nga kursimi në mallra dhe shërbime në mënyrë të pacenuar aktivitetin e organizatave buxhetore.

Sa i përket buxhetit të komunave është përgatitur në përputhje me kalendarin buxhetor në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Ligjin për financat e pushtetit lokal. Buxheti i komunave do të jetë 422 milion euro dhe është paraparë financimi i shtesë për Hoqën e Madhe, për Zym të Prizrenit, është parapa financim për shërbime rezidenciale që e ka paraparë Ministria e Punës për tetë komunat. Deri në fund të shtatori i kemi 30 komuna që e kanë përgatitur buxhetin sipas kufijve buxhetor. Këto ditë buxhetin e ka miratuar Komuna e Junikut sipas qarkores buxhetore. Komuna e Kllokotit nuk e ka aprovuar buxhetin për 2016, Komuna Glllogocit e ka aprovuar por nuk e ka përdorur as strukturën e as kufijtë. Komuna e Zveqanit, Zubin Potokut, Leposaviqit dhe Mitrovicës së Veriut e kanë aprovuar buxhetin brenda afatit ligjor, por jo sipas kufijve buxhetor dhe ndarja e buxhetit nëpër këto komuna është bërë sipas Ligjit të menaxhimit të financave publike.

Për herë të parë këtë vit e kemi bërë një analizë për shpenzimet e karakterit funksional dhe 22% të shpenzimeve shkojnë për çështje ekonomike, kryesisht në infrastrukturë por edhe në projekte tjera kapitale, 22 % shkojnë për çështje sociale, siç janë pensionet dhe kategori tjera, 17% shkojnë në arsim, 11% shkojnë në shëndetësi, 9% për rend e siguri, 4% në mbrojtje, qështje banimi e komunitet, 3% rekreacion dhe kulturë 2%.

Kryetari – pyeti si do të mbulohet deficitin buxhetor, kur dihet se buxheti është hartuar bazuar në rregullën fiskale aktuale? -

Avdullah Hoti – në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike është përfshirë klauzola e investimeve, mirëpo pasi që ligji nuk është miratuar ende, ky buxhet që ne e kemi dorëzuar është në përputhje me rregullën fiskale me ligjin ekzistues pra në kufizimet prej 2 % të deficitit buxhetor në relacion me GDP. Realisht, ne e kemi dorëzuar buxhetin me deficit buxhetor prej 1.6% e GDP-së, sepse ju e dini që vitin e kaluar e kemi përmbyllur me deficit buxhetor mbi rregullën fiskale dhe ligji na detyron që në vitet e ardhshme të kompenzojmë tejkalimin e deficitit buxhetor mbi 2%. Vitin e ardhshëm planifikojmë ti kemi 100 milion euro shtesë të financimit vjetor, përveç kësaj edhe financimi përmes letrave të brendshme me vlerë. Ndërkaq, huan që e kemi me FMN-në është mbështetje direkte buxhetore, e kreditë tjera janë drejtpërdrejt nëpër projekte specifike nëpër ministrit e linjës. Pas miratimit të ndryshimeve të Ligjit të menaxhimit të financave publike, duke shfrytëzuar klauzolën e investimeve, presim të marrim kredi për projektet strategjike që do ti akomodojmë në buxhetin e ardhshëm dhe kjo do të mundësojë që buxheti të arrijë në 2 miliard euro brenda vitit.

Safete Hadergjona - sa i përket faqes së parë që ka të bëjë më të hyrat dhe shpenzimet po shihet se buxheti është i harmonizuar me FMN-në dhe ne si komision nuk jemi të interesuar të prishim marrëveshjen e Qeverisë me FMN-në, mirëpo në brendin e buxhetit ka vend dhe hapësirë për të bërë ndryshime. Si koalicion qeverisës kemi thënë se do ti japim fuqi dhe prioritet sektorit të bujqësisë i cili sektor do të kontribuoj në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Po ashtu kemi deklaruar se do te punojmë në përmirësimin e gjendjes në shëndetësi, do ta përmirësojmë cilësinë e arsimit, por nëse e shikojmë projektbuxhetin nuk jep për të kuptuar se në këto tri fusha jemi duke investuar mjaftueshëm e që janë shumë domethënëse për zhvillimin ekonomik dhe për jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ajo çka më ka bërë përshtypje në buxhet ka lëvizje pozitive qoftë edhe modeste në të hyra dhe në disa shpenzime që janë te domosdoshme. Te investimet kapitale rreth 88% e projekteve janë të bartura nga viti 2015, atëherë shtrohet pyeja çfarë po fusim risi në vitin 2016 në këtë aspekt. Po ashtu në buxhet janë parashikuar shumë investime kapitale për projekte që nuk janë të definuara. Çështja e reformës në administratën publike po i kushton buxhetit 15 milion euro. Me këtë reformë po merremi që disa vite

dhe nuk po ende kemi ngritje të kapaciteteve në administratën publike. Pse çdo reformë që bëhet në administratën publike duhet me pas implikime buxhetore? Sa i përket buxhetit për rastet sociale, po më intereson se në kuadër të ligjit për familjet e dëshmorëve, invalidëve e viktimave të luftës, janë paraparë kompensimi i kategori e viktimave të luftës edhe gratë e dhunuara, a është paraparë buxhet edhe për këtë kategori? Në buxhet nuk e pash që është përfshirë financimi i RTK-së. E di që në prill të këtij viti ka përfunduar afati i financimit të përkohshëm të RTK-së nga Buxheti i Kosovës, mirëpo për aq sa jam në dijeni, as RTK-ja, as qeveria e as Kuvendi nuk është marrë me financimin e këtij institucioni. Projektet në kuadër të nivelit qendror por edhe në kuadër të komunave duhet ti saktësojmë për çka është fjala dhe të mos të bëjmë punë për të miratuar një projekt që ti fitojmë 50 apo 60 vota, por të punojmë për interesin e përgjithshëm dhe për perspektivë në qytetarëve tanë.

Kryetari - qështja e financimit të RTK-së nuk është kompetencë e qeverisë por e Kuvendit. Me Ligjin për RTK-në në muajin prill ka kaluar koha e financimit nga buxhet, menaxhmenti edhe bordi i RTK-së janë të obligua që me e paraqit propozimin për për mënyrën e financimit dhe ne presim rekomandimin e komisionit funksional.

Avdullah Hoti – sa i përket fushës së bujqësisë, për vitin e ardhshëm kemi buxhet prej 57.1 milion euro, ndërsa vitin e kaluar ka qenë 55.6 milion euro. Po është dasht me e ndërru strukturën dhe nuk i kemi prek subvencionet po pjesën e granteve dhe është bërë për projekte kapitale për të ruajtur balancin të investimeve kapitale. Te reforma e administratës publike nuk ka buxhet të ndarë, por në ministri ka projekte të caktuara që janë në fuksion të reformës, si psh. projekti për bashkimin e doganave dhe ATK-së, aplikimi i sistemit të IT-së nëpër organizata buxhetore. Sa i përket Ligjit për pjestarët e luftës, për vitin e ardhshëm i kemi të buxhetuara 25 milion euro, që përfshihen edhe kategoritë tjera. Te projektet e pa specifikuara në nivelin komunale ajo është qështje e autoriteteve komunale dhe nuk mundemi me ndërhy në projektet e tyre kapitale. Tek niveli qendror janë projekte për rrugë regjionale, kryesisht të pa specifikuara dhe ato shpërndahen përmes nënshkrimit të memorandumerve të mirëkuptimit me kuvendet komunale dhe procedurat e shfrytëzimit të këtyre e mjeteve janë plotësisht transparente.

Labinothë Demi-Murtezi - ajo që mua më shqetëson në këtë buxhet është mospërfshirja e fondit për sigurimet shëndetësore. Tjetër shqetësim i radhës është mungesa e fondeve për autostradën e Gjilanit dhe kjo qështje po shtyhet vit pas viti. Kemi dëgjuar nga ministri infrastrukturës se ky projekt do të realizohet në vitin 201, por nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret dhe kjo po shifet edhe në mungesën e ndarjeve buxhetore në buxhetin e vitin të ardhshëm për këtë projekt. Sa i përket reformës në administratën publike, nëse qeveria ndonjëherë duhet të shtojë punëtor shtesë, do të ishin gjuhëtarët ata që të futeshin në punën e tyre, kur kemi parasysh gabimet e mëdha gjuhësore që bëhen në projektligje, madje edhe emërat e komunave në disa vende i kemi gabim dhe kësaj qështje duhet ti qasemi seriozisht.

Avdullah Hoti - fondi për sigurimet shëndetsore ka qenë pjesë fillestare e buxhetit për 2015, mandej në rishikim e kemi hequr sepse minsitri i shëndetësisë e ka vërejtur se ka nevojë më shumë për përgaditje, për punësim të stafit adekuat, për instalim të softwerve e paisjeve tjera për agjensionin për fondin e shërbimeve shëndetsore. Tek autostrada e gjilanit, ministri është duke punuar intenzivisht dhe është e pamundur që punët të fillojnë në vitin 2016, presim që gjatë vitit 2016, të finalizohen shpronësimi dhe të fillojmë me projektin në vitin 2017.

Labinothë Demi - Murtezi- më habit fakti se nuk ka pas përgaditje të duhura për shërbime shëndetësore, kur dihet fakti se në vitin 2014 ka qenë një marrëveshje me kontratë ligjore me Bankën Botërore e cila ka ndarë 12 milion euro. Ju po thonë se nuk ka qenë përgaditjet e duhura, atëherë si ka pranuar Banka Botërore me një marrëveshje me Ministrin e Shëndetësisë. Unë nuk e shoh si mungesë të përgaditjes por me shumë mungesë të vullnetit.

Avdullah Hoti - nuk as mungesë vullneti dhe as mungesë të buxhetit dhe ju e dini që kjo ka qenë pjesë e buxhetit në vitin 2015 është qështje teknike për përgaditje në ministrinë e shëndetësisë. Ne nuk mundemi të fillojmë nëse nuk bëhen të gjitha përgaditjet për këtë projekt.

Besa Gaxherri – nëse e shikojmë buxhetin, është me të ardhë mirë që strukutra e këtij buxheti është e trajtuar brenda mundësive. Përkundër që ka krizë globale financiare, parashikimet për rritje ekonomike janë 4% dhe e dijmë që kërkesat që ka vendi ynë janë të mëdha, por ne duhet të jemi real dhe të buxhetojmë në bazë të këtyre të hyrave që kemi. Më vjen mirë që nuk është cenuar buxheti për investime kapitale, por natyrisht kemi hapërisë të diskutojmë buxhetin e organizatave buxhetore dhe pasi që jemi të ndarë në raportues, ne mund ti ftojme ministrat dhe ti pyesin për qështjet që janë të rëndësishme dhe që u ngritën edhe këtu, siç është rasti i sigurimeve shëndetësore. Jam shumë lumtur që i keni kursyer 6 milion euro në mallra dhe shërbime dhe po shifet se vërtetë ka një seriozitet në qeveri dhe përkundër buxhetit që është i vogël ka rritje në kategoritë e asistencës sociale dhe për pensionet. Ne duhet orientohemi dhe të punojmë që buxhetin ta ndajmë aty ku ka nevojë.

Fikrim Damka - edhe unë përgëzoj që ky buxhet i vitit 2016 është i mirë po do ti paraqes shqëtsimet që i kam paraqitur edhe në vitin 2015 që ka të bëjmë me ndarjen e buxhetit për komunitete, edhe pse ka kaluar amendamenti në Kuvend, ai nuk është respektuar dhe përkundër që është premtuar sde do të rregullohet kjo qështje, po e shoh se as në vitin 2016 dhe parashikimet për vitet 2017-2018 nuk është bërë ndaja e buxhetit sipas komuniteteve. Këtu po përmendet një projekt, unë mendoj se nuk e kemi të përbashkët këtë projekt, por duhet me u nda se cilat janë ato projekte në tri vite. Ne do të paraqesim amendament për këtë qështje apo ndoshta duhet të abstenojmë për këtë buxhet. Është thënë se do t'iu drejtohem Kryeministrit që të nxjerr një vendim për ndarjen e mjeteve për komunitete por kjo nuk ka ndodhur. Disa paqartësi i kam në Prizren, se në vitin e kaluar i kemi pasur 150,000 euro për qendrën kulturore turke, por për këtë vit janë zvogëluar për 50,000 euro dhe 100,000 euro nuk di ku janë? Kemi edhe rastin e qendrës kulturore të Mitrovicës që i kanë ndarë vetëm 20,000 euro dhe që katër vite është duku u zhvilluar ky projekt dhe nuk ka përfunduar ende dhe këtu do të duhej të ndërhyjmë që ta rrisim buxhetin. Një pyetje tjetër ka të bëjë me mjetet e parapara për ujë në Prishinë, a është fabrikë për prodhimin e ujit apo do ta bëjë filtrimin e ujit?

Agim Krasniqi – krahasuar me vitin e kaluar me këtë buxhet është paraparë rritje më e madhe. Institucionet mbledhjes së të hyrave kanë shënuar ngritje të efikasitetit të mbledhjes së të hyrave. Sa i përket ligjit për sigurimet shëndetësore kemi kërkuar me u themelue agjensionin për menaxhim shëndetësor si agjension i veçant që do të udhëheq me fondet e me ligjin shëndetësor. Ky agjension duhet të krijoj infrastrukturën e legjislacionit sekondar në mënyrë që fillojmë me u mbledhë fondet e financimit. Ndërkaq me buxhet mund të reflektojmë në rishikim.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-327**

Kryetari – plotësimi dhe ndryshimi i ligjit për prokurimin publik ka të bëjë me krijimin e bazës ligjore për fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik. Është paraparë një avansim i trajnimeve që ka të bëjë edhe me qështjen elektronike. Ne si komision kemi bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të prokurimit publik dhe kemi nxjerr disa rekomandime që janë marrë parasysh me këtë ligj, mirëpo kanë mbetur edhe disa qështje që duhet diskutuar. Sa i përket ligjeve të prokurimit publik, gjithmonë na është thënë se është në përputhje me standardet e BE-së dhe është hera e gjashtë që ndryshohet dhe sapo të miratohen ligjet thuhet se nuk është në përputhje me direktivat e BE-së dhe duhet të ndryshohet. Në ndryshimin e fundit të ligjit të prokurimit publik është bërë diskriminim duke iu dhënë përparësi në poentim ndërmarrjeve vendore në procesin e tenderimit. Kushtetua e Kosovës nuk e lejon këtë diskriminim lidhur me konkurrencën. Ne duam një ligj të prokurimit që është transparent dhe i zbatueshëm dhe ata që e zbatojnë janë mirë të trajnuar.

Avdullah Hoti - me procedimin e këtij ligji po përmbushim një objektivi të programit të qeverisë për të ruajtur edhe për të shfrytëzuar në mënyrë efikase paratë publike. Janë 800 milion euro, ku qeveria e Kosovës në baza vjetore i kryen përmes procesit të prokurimit Ky projektligj e avanson prokurimin publik në shumë fusha. I kemi definuar shumë mirë procedurat e prokurimit që mos të jenë të stërgjatura, dhe të jenë të definuar autorizimet e secilit zyrtar të prokurimit. Projektligji parasheh një sistem trajnimi të definuar për mbi 1000 zyrtarë për nëpër divizione të ndryshme të nivelit qëndror e lokal. Projektligji tregon me detaje fushën e sigurisë e të mbrojtjesë, për të siguruar se mallrat shumë specifike janë standard, por nuk paraqesin sekret shtetror. Një ndryshim i madhë kanë të bëjë me ndarjen e kontratave publike homogjene e heterogjene ku janë përfshirë ndërmarrjet e mëdha, të vogla e të mesme. Po ashtu projektligji mundëson pagesën e drejtpërdrejtë për nënkontraktorët nga autoriteti kontraktues. Një reformë e madhe sa i përket ekonomizimit të shpenzimeve publike që i kemi kryer ku kemi krijuar bazën ligjore që të gjitha agjensionet në organizata të ndryshme buxhetore që janë nën autoritetin e Kuvendit apo qeverisë, që kanë me pak se 50 të punësuar, shërbimet për këto organizata të kryen Kuvendi apo ministrinë përkatëse. Projektligji ka përcaktuar kushtet specifike në kontrata publike që janë rekrutimi i personave me aftësi të kufizuara, prokurimi me barazi gjinore. Shuma e sigurimit të tenderit që kërkohet nga kontraktuesi është ulur nga 3% në 1%. Qka është e rëndësishme me vendim të veçantë të qeverisë është përcaktuar që prokurimi elektronik në Kosovë të bëhet i obligueshëm për të gjitha organizatatë buxhetore.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-327.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Amendamenteve të Komisioni funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetari – theksoi se projektligji nuk përmban kosto shtesë buxhetore, mirëpo janë dy nene që kanë të bëjnë me qështjen e financimit dhe shfrytëzimin e të hyrave të Autoritetit që mendojë se duhet të ndërhyjmë dhe një amendament i komisionit funksional që është riformulim i njërit prej neneve.

Propozojë që bëjmë dy amendamente. Neni 11 të riformulohet: Autoriteti financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Si dhe paragrafi 3 i nenit 14, të riformulohet si vijon: 3.Të hyrat nga taksat e Autoritetit derdhen në

Buxhetin e Republikës së Kosovës. Ndërsa, të rekomandojmë që amendamenti 6 i komisionit funksional që i referohet ndryshimeve në paragrafin 3 të nenit 14, të hiqet.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 11 dhe paragrafit 3 të nenit 14.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendamentet në Projektligjin nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 11 riformulohet si vijon:

Neni 11

Burimet e financimit

Autoriteti financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Amendamenti 2

Neni 14, paragrafi 3 riformulohet si vijon:

“Të hyrat nga taksat e Autoritetit derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës”.

3. Amendamentet e propozuara nga Komisionin Funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për Projektligjin nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të amendamentit 6, i cili rekomandohet të fshihet.
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-18 për Provimin e Maturës Shtetërore dhe Amendamenteve të Komisioni funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport**

Kryetari – projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligjit nr.05/L-18 për Provimin e Maturës Shtetërore, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e Komisioni funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Të ndryshme

7.1. **Kryetari** – njoftoj se KQZ ka dërguar raportin vjetor financiar për Fondin për mbështetjen e Subjekteve Politike për vitin 2014, por nuk po më duket e arsyeshme që të shqyrtojmë deri sa nuk bëhet auditimi i këtij fondi. Në kohën kur bëhet auditimi ne mundemi me shqyrtue pjesën e raportit financiar.

7.2. **Kryetari** – në lidhje me shqyrtimin e Projektbuxhetit në Komision, ne duhet të organizohem dhe të shqyrtojmë dhe amendamentojmë atë. I kemi themeluar edhe raportuesit dhe do të ndahemi në grupe pune. Kuvendi duhet ta miratojë deri me 9 dhjetor. Kjo është kërkesë e FMN-së në bazë të marrëveshjes me Qeverinë ku buxheti për dy vjet përfiton mjete direkte buxhetore në shumë prej 184 milion euro. Prandaj ne duhet të organizohem dhe të fillojmë më punë më herët. Të thrrasim ministrat në dëgjime buxhetore, qoftë edhe ti trajtojmë qështjet që u ngriten këtu, siç ishte rasti me sigurimet shëndetësore apo qështja e ndarjes së projekteve për komunitete. Ne mund të shqyrtojmë buxhetin, kërkesat, ndërsa vendimet i marrim pasi që të miratohet në lexim të parë në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani